

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR
IRSA-PERLA Sh.p.k.**

- Z. Klajdi Shopi, atësia Albert datëlindje 03.12.1978 qytetar i Shqipërisë, me vendlindje Elbasan dhe banim në Elbasan.
- Z. Gentian Shopi, atësia Hysen datëlindje 22.03.1974 qytetar i Shqipërisë, me vendlindje Elbasan dhe banim në Elbasan.

kam vendosur të nënshkruaj Aktin e Themelimin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është **IRSA-PERLA Sh.p.k.**

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Elbasan Lagja 29 Nentori,, Rruga Metalurgjise kilometri 1 ndertesa nr 26/4 .kat 2 ELBASAN SHQIPERI .

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 - Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

- Agjensi për ndërmjetësim tregtar. Gjerimi i punëve të të tjerve (sipas parashikimeve të nenit 648-652 te Kodit Civil). Konsulence në përgatitje dokumentacioni, ndjekje e të gjitha procedurave për regjistrim të shoqërive të krijuara rishtazi, deri në dhënien e licencës nga organi përkatës për fillimin e ushtrimit të aktivitetit. Shërbim marketingu, menaxhimi, administrimi, Konsulencë marrëdhene tregtare, përpilim dhe depozitim dokumentash të shoqërive tregtare të regjistruara si subjekte të së drejtës shqiptare apo të huaj. Konsulencë në distancë dhe me anë të përfaqesuesve të brendshëm pranë shoqerive tregtare. Shoqëria mund të mbaje, bleje, shese, shkembeje hapesira reklamimi; kompania do te jete ne gjendje te bleje dhe te shkembeje mallra dhe sherbime qe do te perdoren per shitje, import-eksport; kryejne te gjitha operacionet tregtare. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjeter që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Neni 5 - Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është Lekë 100,000 (njëqindmijë) i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakeve në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të ketij Akti.

Neni 6 - Kontributet

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Z. Klajdi Shopi, atësia Albert datëlindje 03.12.1978 qytetar i Shqipërisë, me vendlindje Elbasan dhe banim në Elbasan të cilit i përket një kuotë, me vlerë nominale Leke 50,000 që i korespondon 50% i kapitalit të Shoqërisë.
- Z. Gentian Shopi, atësia Hysen datëlindje 22.03.1974 qytetar i Shqipërisë, me vendlindje Elbasan dhe banim në Elbasan të cilit i përket një kuotë, me vlerë nominale Leke 50,000 që i korespondon 50% i kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 - Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. Klajdi Shopi, atësia Albert datëlindje 03.12.1978 qytetar i Shqipërisë, me vendlindje Elbasan dhe banim në Elbasan, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9- Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKET

Klajdi Shopi

Thule Shop

Gentian Shopi

Gent Shop

Data: 08.11.2022